

Administrimi i vaksinës kundër COVID-19 në Kosovë

Disa shembuj nga vendet e tjera

Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi të shkurtër është të sjell disa praktika rreth administrimit dhe shpërndarjes së vaksinave kundër COVID-19 nga vendet të cilat tashmë i kanë siguruar këto vakcina. Kjo me qëllim të ofrimit të rekomandimeve për institucionet publike rreth shpërndarjes së vaksinave, më konkretisht Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Në këtë punim janë treguar praktikat e katër (4) vendeve të Bashkimit Evropian dhe tre (3) vendeve të rajonit në administrimin e vaksinave kundër COVID-19. Duke marrë parasysh numrin e popullsisë në Kosovë, në radhë të parë janë marrë praktika nga vende të vogla si Lituania dhe Luksemburgu. Pastaj, me qëllim të ofrimit të shembujve nga vende me karakteristika të ndryshme dhe me popullsi pak më të madhe se Kosova, është marrë Greqia, e cila mund të merret edhe si shembull i suksesshëm në administrimin e vaksinës kundër COVID-19 (deri tani ka vaksinuar 1.14 milion qytetarë). Vendi i katërt është marrë Franca si një nga vendet me popullsi të madhe dhe po ashtu traditës së mirë hulumtuese në farmaci dhe me kompani të mëdha në prodhimin e barnave të ndryshme.

Nga shtetet e rajonit që janë marrë si shembuj janë: Shqipëria, e cila rishtazi ka filluar vaksinimin dhe është shembull i mirë për shpejtësinë e vaksinimit. Maqedonia Veriore ka siguruar numër të vogël të dozave të vaksinës dhe kjo paraqet rast të mirë për mënyrën e prioritetizimit të grupeve për vaksinim.

Administrimi i vaksinës në Lituani

Vaksinimi kundër COVID-19 në Lituani ka filluar më 27 dhjetor 2020 Rastet e para me virusin COVID-19 në Kosovë janë paraqitur me 13 mars 2020.¹ Që nga fillimi i vaksinimit

¹ The Baltic Times 'Lithuania starts vaccinations against

deri më 31 mars 2021 Lituania ka siguruar rreth 515,287 doza vaksinash. Llojet e vaksinave të siguruara janë nga kompanitë: Moderna, Oxford/AstraZeneca, Pfizer/BioNTech.² Numri i popullsisë në Lituani deri në vitin 2020 vlerësohet të jetë 2,722,289.³ Në Lituani numri i personave të vaksinuar një herë (me një dozë) deri më 31 mars është 349,571, ndërsa numri i personave të vaksinuar dy herë (me dy doza) është 165,716. Prioritizimi i grupeve për vaksinim në Lituani, është zhvilluar përmes një plani të vaksinimit i cili është aplikuar përmes dy fazave.

- Në fazën e parë janë vaksinuar punonjësit shëndetësor në të gjitha spitalet, vullnetarët, vozitësit e ambulancave, banorët në shtëpitë e të moshuarve dhe punonjësit social në këto institucione, punonjësit e barnatoreve, laboratorëve dhe personat mbi moshën 65 vjeçare;
- Në fazën e dytë janë vaksinuar personat që punojnë në institucionet parafillore, fillore dhe në edukimin special, personat me probleme shëndetësore, personat që punojnë në shërbime të veçanta etj;⁴

Vlen të përmendet se para vaksinimit në shtëpinë e të moshuarve, këtyre të fundit i është bërë testi i shpejtë për të vërtetuar nëse personi e ka kaluar virusin pa simptoma dhe, nëse e kanë kaluar në këtë mënyrë, nuk janë vaksinuar.

Administrimi i vaksinës në Luksemburg

Vaksinimi në Luksemburg ka filluar më 6 mars 2021.⁵ Që nga fillimi i vaksinimit deri më 1 prill Luksemburgu ka siguruar rreth 99,356 doza të vaksinave. Llojet e vaksinave të siguruara janë nga kompanitë: Moderna, Oxford/AstraZeneca dhe Pfizer/BioNTech.⁶ Numri i popullsisë në Luksemburg deri në vitin 2020 vlerësohet të jetë 625,978.⁷ Numri i personave të vaksinuar një herë (vetëm me një dozë) deri më 1 prill është 75,862, ndërsa numri i personave të vaksinuar dy herë (me dy doza) është 23,494.⁸ Kategorizimi i grupeve për vaksinim në Luksemburg është bërë si në vijim:

- Punonjësit shëndetësor dhe stafi spitalor;
- Vozitësit e ambulancave;
- Banorët në shtëpitë e të moshuarve dhe punonjësit social në këto institucione.⁹

Administrimi i vaksinës në Francë

Vaksinimi në Francë ka filluar më 27 dhjetor 2020.¹⁰ Që nga fillimi i vaksinimit deri më 1 prill Franca ka siguruar 11.77 milion doza të vaksinave, llojet e vaksinave të siguruara janë nga kompanitë: Moderna, Oxford/AstraZeneca, dhe Pfizer/BioNTech.¹¹ Numri i personave të vaksinuar një herë (vetëm me një dozë) deri më 1 prill është 8.83 milion, ndërsa numri i personave të vaksinuar dy herë (me dy doza), është 2.94 milion. Kategorizimi i grupeve për vaksinim në Francë është bërë si në vijim:

- Punonjësit shëndetësor;
- Banorët në shtëpinë e të moshuarve dhe punonjësit social në këto institucione;
- Kujdestarët shëndetësor të personave me sëmundje paraprake, të moshës mbi 50 vjeç.
- Zjarrfikësit.¹²

■ Që nga fillimi i vaksinimit deri më 1 prill Franca ka siguruar

11.77

milion doza të vaksinave, llojet e vaksinave të siguruara janë nga kompanitë: Moderna, Oxford/AstraZeneca, dhe Pfizer/BioNTech

COVID-19': <https://bit.ly/3cL86Jr>

2 Our World in Data 'Coronavirus (COVID-19) Vaccinations': <https://bit.ly/3ur6M4B>

3 Worldometer, 'Population in Lithuania': <https://bit.ly/3tg7CAA>

4 LRT English Newsletter 'Who will get vaccinated in Lithuania and when': <https://bit.ly/3fCUgJZ>

5 The Luxembourg Government 'Start of vaccinations against COVID-19 for residents in nursing homes': <https://bit.ly/39FKunN>

6 Our World in Data 'Coronavirus (COVID-19) Vaccinations': <https://bit.ly/2PXeleY>

7 Worldometer, 'Population in Luxembourg': <https://bit.ly/32aepAc>

8 Our World in Data 'Coronavirus (COVID-19) Vaccinations': <https://bit.ly/2PXeleY>

9 The Luxembourg Government 'First people vaccinated against COVID-19 in Luxembourg': <https://bit.ly/2R75LjN>

10 The Connexion 'France begins Covid-19 vaccination programme': <https://bit.ly/2PVIHUq>

11 Worldometer, 'Population in France': <https://bit.ly/32az6ft>

12 The Connexion 'France begins Covid-19 vaccination programme': <https://bit.ly/2PVIHUq>

Administrimi i vaksinës në Greqi

Vaksinimi në Greqi ka filluar më 27 dhjetor 2020.¹³ Që nga fillimi i vaksinimit deri më 1 prill 2021 Greqia ka siguruar 1.78 milion doza të vaksinave, llojet e vaksinave të siguruara janë nga kompanitë: Moderna, Oxford/AstraZenec dhe Pfizer/BioNTech.¹⁴

Numri i popullsisë në Greqi deri në vitin 2020 vlerësohet të jetë 10,423,054.¹⁵ Numri i personave të vaksinuar një herë (vetëm me një dozë) deri më 2 prill 2021 është 1.14 milion, ndërsa numri i personave të vaksinuar dy herë (me dy doza) është 641,917. Kategorizimi i grupeve për vaksinim në Greqi është bërë si në vijim:

- Punonjësit shëndetësor, banorët në shtëpinë e të moshuarve dhe stafi mbështetës;
- Personat mbi 85 vjeç;
- Personat mbi 70 vjeç;
- Personat mbi 60 vjeç, personat me sëmundje kronike, si dhe punonjësit e administratës publike;
- Personat mbi 18 vjeç.¹⁶

Administrimi i vaksinës në Shqipëri

Vaksinimi në Shqipëri ka filluar më 11 janar 2021.¹⁷ Që nga fillimi i vaksinimit deri më 31 mars 2021, Shqipëria ka siguruar rreth 119,321 doza të vaksinave, lloji i vaksinave të siguruara është nga kompania: Pfizer/BioNTech.¹⁸

Numri i popullsisë në Shqipëri deri në vitin 2020 vlerësohet të jetë 2,877,797.¹⁹ Numri i personave të vaksinuar një herë (vetëm me një dozë) deri më 22 shkurt është 6,073 ndërsa numri i personave të vaksinuar dy herë (me dy doza) është 655. Kategorizimi i grupeve për vaksinim në Shqipëri është bërë si në vijim:

- Personeli arsimor (mësuesit);
- Të moshuarit mbi moshën 80 vjeçare;
- Personeli shëndetësor.²⁰

Administrimi i vaksinës në Maqedoninë e Veriut

Vaksinimi në Maqedoninë e Veriut ka filluar më 17 shkurt 2021.²¹ Që nga fillimi i vaksinimit deri më 2 prill 2021 Maqedonia Veriore ka siguruar rreth 8,398 doza të vaksinave, llojet e vaksinave të siguruara janë nga kompania: Pfizer/BioNTech.²²

Numri i popullsisë në Maqedoninë e Veriut deri në vitin 2020 vlerësohet të jetë 2,083,374.²³ Numri i personave të vaksinuar një herë (vetëm me një dozë) deri më 2 prill 2021 është 8,398 ndërsa numri i personave të vaksinuar dy herë (me dy doza) nuk ka ende të dhëna. Kategorizimi i grupeve për vaksinim në Maqedoninë Veriore është bërë si në vijim:

- Punonjësit shëndetësor dhe infermierët kryesorë të cilët punojnë në qendrat e klinikave infektive;
- Personat mbi moshën 65 vjeçare.²⁴

Administrimi i vaksinës në Kosovë

Që nga 13 marsi 2020 kur janë paraqitur rastet e para me COVID-19 deri më 31 mars 2021, në Kosovë kanë qenë të konfirmuara rreth 90.430 raste me COVID-19, raste aktive janë 13.804 dhe 1,872 raste të



Në Kosovë që nga 13 marsi 2020 kur janë paraqitur rastet e para me COVID-19 deri më 31 mars 2021 kanë qenë të konfirmuara rreth

90.430

■ raste pozitive me COVID-19, raste aktive janë 13.804 dhe 1,872 raste të vdekjes me këtë virus.

13 Greek Reporter 'Greece Starts Coronavirus Vaccination Operation': <https://bit.ly/3cOHszp>

14 Our World in Data 'Coronavirus (COVID-19) Vaccinations': <https://bit.ly/2PXeleY>

15 Worldometer, 'Population in Greece': <https://bit.ly/32azóft>

16 Keep Talking Greece 'Covid-19 vaccination in Greece: All you need to know about procedures': <https://bit.ly/3mkhJlv>

17 France24 'Albania starts Covid-19 vaccinations as PM blasts slow EU help': <https://bit.ly/3mhdEi7>

18 Our World in Data 'Coronavirus (COVID-19) Vaccinations': <https://bit.ly/3fCQ0k>

19 Worldometer, 'Population in Albania': <https://bit.ly/3sigDkK>

20 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 'Vaksinimi antiCOVID/Kryhen 36,619 vaksinime': <https://bit.ly/39IK6ER>

21 China.org.cn 'North Macedonia starts vaccination against COVID-19': <https://on.china.cn/3fCW9HH>

22 Our World in Data 'Coronavirus (COVID-19) Vaccinations': <https://bit.ly/31LqaNf>

23 Worldometer, 'Population in North Macedonia': <https://bit.ly/3wX9n8y>

24 U.S.News 'North Macedonia Begins COVID-19 Vaccination': <https://bit.ly/3sS61kg>

vdekjes me këtë virus.²⁵ Numri i popullsisë në Kosovë deri në vitin 2020 vlerësohet të jetë 1,782,115.²⁶ Në mesin e vendeve të rajonit, Kosova është vendi që ka pranuar më me vonesë vaksinat kundër COVID-19, përkatësisht me 28 mars 2021. Numri i dozave të siguruara është 24 mijë nga kompania AstraZeneca.

Sipas Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet që të siguroj për të gjithë qytetarët vaksinat të mjaftueshme kundër virusit COVID-19.²⁷ Në shërbim të këtij qëllimi, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë buxhet në vlerë prej 40 milion euro për blerjen e vaksinave kundër COVID-19. Po ashtu, Qeveria ka miratuar Planin Shtetëror të Vaksinimit kundër COVID-19²⁸, i cili ka qenë i paraparë me ligjin në fjalë. Plani në fjalë ka planifikuar vaksinimin në tri faza:

- Në fazën e parë është paraparë vaksinimi i 12,825 personave (apo 95% e punëtorëve shëndetësorë) dhe atë me nga dy doza. Pastaj, duke i shtuar edhe numrin e dozave të parapara si të humbura, numri total i dozave të parapara për vaksinimi të punëtorëve shëndetësorë (sipas planit të ministrisë) është 28,500 doza. Pastaj në fazë të parë është paraparë vaksinimi edhe i 1,187 personave (apo 95% e banorëve në shtëpitë e pleqve dhe punëtorët socialë), po ashtu me nga dy doza, dhe duke llogaritur edhe numrin e dozave që mund të humbin gjatë përdorimit (llogaritur si 10% në secilën kategori²⁹), numri i dozave të parapara për këtë kategori është 2,637 gjithsej. Po ashtu, në këtë fazë është paraparë edhe vaksinimi i 31,350 personave (apo 95% e banorëve mbi 80 vjeç), me nga dy doza dhe duke llogaritur humbjet, numri i dozave të parapara për këtë kategori është 69,667 gjithsej. Si kategori e katërt në fazën e parë është paraparë vaksinimi edhe i 5,938 personave (apo 95% e personave me sëmundje kronike), po ashtu me nga dy doza dhe duke llogaritur edhe humbjet, numri i dozave të parapara për këtë kategori është 13,197 gjithsej.;
- Në fazën e dytë është paraparë vaksinimi i 126,681 personave të moshës 65-69 vjeçare, 128,667 persona me sëmundje kronike, 31,645 mësimdhënës dhe 3,708 pjesëtarë forcës së sigurisë.³⁰ Vlen të ceket se sipas planit, madhësia e grupit (kategorisë) dhe caku i mbulimit me vaksinim dallon për 5%.
- Në fazën e tretë është paraparë vaksinimi i 316,279 personave të moshës 40-64 vjeçare, 91,209 persona me sëmundje të tjera, 14,110 i punëtorëve të sektorit publik dhe 433,402 persona tjerë.³¹ Vlen të ceket se edhe në këtë rast, madhësia e grupit (kategorisë) dhe caku i mbulimit me vaksinim dallon për 5%.

Plani Shtetëror i Vaksinimit kundër COVID-19 është hartuar mbi pritshmërinë e sigurimit të 54,000 dozave të vaksinës sa ishte planifikuar në fillim dhe raportuar në publik dhe jo 24,000 sa kanë arritur deri tani në Kosovë. Në këtë mënyrë, mbulimi vetëm i punëtorëve shëndetësor (12,825 me një dozë) apo (28,500 me dy doza duke përfshirë humbjet), është i pamundur me këtë numër të siguruar të dozave deri tani. Pastaj, nëse vendet tjera kanë prioritetizuar punëtorët shëndetësor si tërësi, mirëpo kanë pasur doza të mjaftueshme për të mbuluar këtë kategori e po ashtu edhe kategori tjera, Kosova nuk mund të shkojë në këtë drejtim me këtë numër të siguruar të dozave sepse janë të pamjaftueshme në këtë fazë.

Sipas D+ është e rëndësishme vaksinimi i shoferëve të autobusëve dhe ndihmësve të shoferëve, zyrtarët policor në terren, punëtorët në sportele të bankave, punojnësit e administratës që janë të angazhuar drejtpërdrejt në shërbimet ndaj qytetarëve, punëtorët e sigurimit pranë klinikave të përfshira në trajtimin e COVID-19, punëtorëve të laboratorëve si dhe farmacive, grupe këto që janë drejtpërdrejtë të rrezikuara nga infektimi dhe bartja e virusit. Një pikë e rëndësishme është edhe vaksinimi i personelit shëndetësor në klinikat private, gjë që nuk ka qenë e paraparë me planin e Ministrisë së Shëndetësisë. Një ndarje e tillë paraqet diskriminim dhe nuk duhet të aplikohet, pasi personeli shëndetësor në klinikat private është i rrezikuar njësoj si në klinikat publike.

25 World Health Organization 'Kosovo Situation': <https://bit.ly/3wmG7aZ>

26 Kosovo Agency of Statistics, 'Statistical Yearbook of 2019 prepared in 2020': <https://bit.ly/3mJdXSQ>





27 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 'Ligji Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës': <https://bit.ly/3dApQX8>

28 Plani Shtetëror i Vaksinimit kundër COVID-19, (18 shkurt 2021): <https://bit.ly/3fJO8Rr>

29 Po aty

30 Po aty

31 Po aty

			Grupet e prioritizuara
 Lituania	Popullësia	2,722,289	<p>Në fazën e parë janë vaksinuar punonjësit shëndetësor në të gjitha spitalet, vullnetarët, vozitësit e ambulancave, banorët në shtëpitë e të moshuarve dhe punonjësit social në këto institucione, punonjësit e barnatoreve, laboratorëve dhe personat mbi moshën 65 vjeçare.</p> <p>Në fazën e dytë janë vaksinuar personat që punojnë në institucionet.</p>
	Fillimi i vaksinimit	27.12.2020	
	Nr. i dozave të administruara	515,287	
	Nr. i personave të vaksinuar një herë	349,571	
	Nr. i personave të vaksinuar dy herë	165,716	
			Grupet e prioritizuara
 Luksemburgu	Popullësia	625,978	<p>Punonjësit shëndetësor dhe stafi spitalor;</p> <p>Vozitësit e ambulancave;</p> <p>Banorët në shtëpitë e të moshuarve dhe punonjësit social në këto institucione.</p>
	Fillimi i vaksinimit	06.03.2021	
	Nr. i dozave të administruara	99,356	
	Nr. i personave të vaksinuar një herë	75,862	
	Nr. i personave të vaksinuar dy herë	23,494	
			Grupet e prioritizuara
 Franca	Popullësia	65,273,511	<p>Punonjësit shëndetësor;</p> <p>Banorët në shtëpinë e të moshuarve dhe punonjësit social në këto institucione;</p> <p>Kujdestarët shëndetësor të personave me sëmundje paraprahe, të moshës mbi 50 vjeç;</p> <p>Zjarrfikësit.</p>
	Fillimi i vaksinimit	27.12.2020	
	Nr. i dozave të administruara	11.77 M	
	Nr. i personave të vaksinuar një herë	8.83 M	
	Nr. i personave të vaksinuar dy herë	2.94 M	
			Grupet e prioritizuara
 Greqia	Popullësia	10,423,054	<p>Punonjësit shëndetësor, banorët në shtëpinë e të moshuarve dhe stafi mbështetës;</p> <p>Personat mbi 85 vjeç;</p> <p>Personat mbi 70 vjeç;</p> <p>Personat mbi 60 vjeç, personat me sëmundje kronike, si dhe punonjësit e administratës publike;</p> <p>Personat mbi 18 vjeç.</p>
	Fillimi i vaksinimit	27.12.2020	
	Nr. i dozave të administruara	1.78 M	
	Nr. i personave të vaksinuar një herë	1.14 M	
	Nr. i personave të vaksinuar dy herë	641,917	




		Grupet e prioritizuara	
 Shqipëria	Popullësia	2,877,797	Personeli arsimor (mësuesit); Të moshuarit mbi moshën 80 vjeçare; Personeli shëndetësor.
	Fillimi i vaksinimit	11.01.2021	
	Nr. i dozave të administruara	119, 321	
	Nr. i personave të vaksinuar një herë	6,073	
	Nr. i personave të vaksinuar dy herë	655	
 Maqedonia Veriore	Popullësia	2,083,374	Punonjësit shëndetësor dhe infermierët kryesorë të cilët punojnë në qendrat e klinikave infektive; Personat mbi moshën 65 vjeçare
	Fillimi i vaksinimit	17.02.2021	
	Nr. i dozave të administruara	8,398	
	Nr. i personave të vaksinuar një herë	8,398	
	Nr. i personave të vaksinuar dy herë	/	
 Kosova	Popullësia	1,789,115	Punonjësit shëndetësor; Banorët në shtëpitë e pleqve dhe punëtorët socialë; Personat me sëmundje kronike; Personat e moshës 65-69 vjeçare; Puntorët në sektorin publik.
	Fillimi i vaksinimit	28.03.2021	
	Nr. i dozave të administruara	24,000	
	Nr. i personave të vaksinuar një herë	/	
	Nr. i personave të vaksinuar dy herë	/	

Tabela 1. Karakteristikat e administrimit të vaksinimit në disa vende, përfshirë Kosovën

Rekomandime

- Vaksinimi i punëtorëve shëndetësor duhet të ndahet nëpër faza varësisht nga numri i dozave të siguruara të vaksinës.
- Në planin për vaksinim të përfshihen edhe personeli shëndetësor i klinikave private dhe laboratoreve që janë të përfshira në trajtimin e rasteve me COVID-19.
- Vaksinimi i një kategorie që vlerësohet prioritet nuk duhet të kryhet me dy doza, nëse numri i dozave të siguruara është i pamjaftueshëm për të vaksinuar një kategori tjetër e cila është po ashtu prioritet, për shembull: banorët e shtëpive të pleqve, personat e moshuar, personat me sëmundje kronike, etj., duhet të vaksinohen me nga një dozë në fazën e parë;
- Në fazën e parë të vaksinimit të përfshihen edhe grupet të cilët kanë kontakt të përditshëm me qytetarë siç janë:
 - Shoferët e ambulancave dhe mjeteve tjera për bartjen e pajisjeve medicinale;
 - Arkatarët/et e marketeve të mëdha të cilat kanë frekuentim të lartë nga qytetarët;
 - Shoferët e autobusëve dhe trenit, kondukterët, si dhe vozitësit e taksive;
 - Mësuesit;
 - Zjarrfikësit;
 - Policia e trafikut;
 - Punëtorët e farmacive dhe laboratorëve;
 - Stafit esencial në administratë që ofron shërbime të drejtpërdrejta për qytetarë.
- Para vaksinimit, personat të testohen me test rapid (të shpejtë) për të përcaktuar nëse personi e ka kaluar virusin dy muajt e fundit, dhe nëse vërtetohet, atëherë personi i njëjtë të vaksinohet në fazën e dytë apo tretë varësisht nga disa specifika si koha e kaluar nga përfundimi i COVID-19, nëse personi është i moshuar, me sëmundje kronike, etj.
- Ministria e Shëndetësisë duhet të përdorë metodën e thirrjes së personave nga Qendrat e Mjekësisë pasi për personat e moshuar është e vështirë përdorimi i metodave online.
- Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) duhet të publikojë rregullisht të dhëna për numrin e personave të vaksinuar, sipas kategorive, dhe t'i vendos ato në faqen e internetit. Kjo e fundit duhet të plotësohet me të dhëna mbi procesin, përfshirë sa njerëz vaksinohen, kush dhe ku, në mënyrë që qytetarët të kenë një pasqyrë të përgjithshme se si po përparon procesi.